
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data 26.06.2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Blerje medalje për Policinë e Shtetit”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):

18512200-3 Medalje

Vlera e fondit limit: 3,900,000 (tre milion e nëntëqind mijë) lekë pa Tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 7

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1.Ofertuesi duhet të paraqesë:

a.Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b.Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. OE duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar ” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b.Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 55, pika 4 (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë (në pronësi / qira ose në përdorim) makineritë dhe pajisjet e mëposhtme:

- | | |
|--|--------|
| 1.Makineri për derdhjen e metaleve | 1 copë |
| 2.Makineri stampim/prerje | 1 copë |
| 3.Makineri lazer për gdhendje | 1 copë |
| 4.Makineri CNC për frezim | 1 copë |
| 5.Furrë për trajtimin e metaleve | 1 copë |
| 6.Furrë për pjekjen e smaltit të nxehtë | 1 copë |
| 7.Linjë galvanizimi për arezimin e medaljeve | 1 copë |

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku përcaktohet: Neni 77 pika 4 e LPP : Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Neni 40 pika 5 gërma (ç) e VKM : Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Shpjegimi mbi funksionin e paisjeve të kërkuara vijon si më poshtë:

1. Makineri për derdhjen e metaleve mundëson prodhimin e pjesëve metalike që përbëjnë bazën e medaljeve, dekoratave, stemave ose produkteve të ngjashme. Procesi i derdhjes mundëson krijimin e formave dhe dimensioneve sipas modeleve të miratuara nga autoriteti kontraktor. Disponimi i kësaj makinerie garanton aftësinë e operatorit ekonomik për të realizuar procesin fillestar të prodhimit dhe për të siguruar uniformitetin e produktit.

2. Makineri stampimit/prerjes përdoret për formësimin e produkteve metalike sipas dimensioneve dhe detajeve të kërkuara në specifikimet teknike. Ajo siguron saktësi në prodhim, uniformitet ndërmjet njësisë dhe përmbushjen e kërkesave estetike e funksionale të produktit final. Për rrjedhojë, kjo pajisje përbën një kapacitet minimal teknik të domosdoshëm.

3. Makineri lazer për gdhendje përdoret për personalizimin e medaljeve, pllaketave apo produkteve të tjera metalike me emra, logo, simbole, data ose elemente grafike. Teknologjia lazer garanton saktësi të lartë, qëndrueshmëri të gdhendjes dhe cilësi uniforme. Kjo makineri është e nevojshme për përmbushjen e kërkesave të personalizimit të produktit sipas specifikimeve të autoritetit kontraktor.

4. Makineri CNC për frezim, bën të mundur përpunimin preciz të sipërfaqeve metalike dhe realizimin e detajeve që nuk mund të arrihen me metoda manuale. Përmes frezimit CNC sigurohet përputhshmëria me dizajnet, dimensionet dhe tolerancat teknike të kërkuara në specifikimet teknike. Kjo pajisje garanton cilësi të lartë, saktësi prodhimi dhe riprodhueshmëri të njëjtë të çdo produkti gjatë gjithë ekzekutimit të kontratës.

5. Furrë për trajtimin e metaleve është një makineri e nevojshme për përmirësimin e vetive fizike dhe mekanike të produktit, si fortësia, rezistenca dhe qëndrueshmëria ndaj konsumit. Disponimi i

furrës siguron që produktet metalike të përmbushin standardet e kërkuara të cilësisë dhe jetëgjatësisë.

6.Furrë për pjekjen e smaltit të nxehtë mundëson procesin thelbësor për fiksimin dhe qëndrueshmërinë e ngjyrave. Furra garanton cilësinë estetike të produktit, rezistencën ndaj konsumit dhe ruajtjen e karakteristikave vizuale gjatë përdorimit.

7.Linjë galvanizimi për arezimin e medaljeve mundëson procesin përfundimtar të trajtimit sipërfaqësor të medaljeve dhe produkteve metalike. Ky proces siguron mbrojtje ndaj oksidimit, rrit rezistencën ndaj korrozionit dhe përmirëson pamjen estetike të produktit. Disponimi i një linje galvanizimi garanton realizimin e përfundimeve sipas standardeve të kërkuara teknike dhe cilësore.

Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për makineritë dhe pajisjet që kanë dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi sipas cilësisë dhe afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të makinerive dhe pajisjeve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh natyrën ,permasat, dhe kohëzgjatjen e kontratës pasi dekoratat duhet të prodhohen posaçërisht sipas përshkrimeve dhe specifikimeve të hartuara nga grupi i punes. Këto pajisje përfaqësojnë kapacitetet minimale teknike të nevojshme për realizimin e proceseve të prodhimit, përpunimit, trajtimit dhe personalizimit të produkteve metalike që përbëjnë objektin e prokurimit. Gjithashtu, njësia gjykon se kërkesa nuk është kufizuese, pasi lejon disponimin e tyre jo vetëm në pronësi, por edhe me qira ose në përdorim, duke garantuar respektimin e parimeve të konkurrencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIME TEKNIKE TË MEDALJEVE

1. MEDALJE “MIRËNJOHJE”



Medalja është rrethore me diametër 35mm, e punuar në metal bronzi të praruar në Ar 999, me finicion mat dhe me shkëlqim e me detaje të relievuara. Në pjesën e sipërme të saj është i gdhendur mbishkrimi “MIRËNJOHJE”, i cili është edhe titulli i medaljes, që shpreh vlerësim dhe falënderim institucional.

Në qendër të medaljes ndodhet emblema e Policisë së Shtetit, e paraqitur në formë mburoje të ndarë vertikalisht në dy fusha:

- Ngjyra blu realizuar me emaljo të qelqtë në anën e majtë me mbishkrimin “POLICIA”,
- Ngjyra e kuqe realizuar me emaljo të qelqtë në anën e djathtë me mbishkrimin “SHTETIT”.

Mbi këtë mburojë qëndron shqiponja dykrenare, simbol kombëtar i shtetit shqiptar, e stilizuar në relief të artë, që përfaqëson autoritetin, sovranitetin dhe mbrojtjen e rendit.

Në pjesën e poshtme të medaljes, anash, ndodhen degë dafine dhe lisi, të stilizuara me emaljo transparente të qelqtë në ngjyrë jeshile me detaje të arta, të cilat simbolizojnë nderin, forcën, qëndrueshmërinë dhe fitoren morale.

Medalja është e varur në një shirit moiré me gjerësi 37mm, me kombinim ngjyrash blu të errët, të zezë dhe të kuqe, të vendosura vertikalisht. Këto ngjyra përforcojnë karakterin zyrtar, serioz dhe patriotik të dekoratës.

➤ **Shiriti i medaljes (Spila ose barreta)**

Spila ose Barreta është me përmasa 35 x 10mm. E realizuar me shirit moiré me kombinim ngjyrash blu të errët, të zezë dhe të kuqe, të vendosura vertikalisht. Nga pas është e pajisur me kapse me dy gjilpëra për tu kapur në xhakëtë.



2. MEDALJE “PËR REZULTATE TË LARTA”



Medalja është rrethore me diametër 35mm, e punuar në metal bronzi të praruar në Ar 999, me finicion mat dhe me shkëlqim e me detaje të relievuara të theksuara artistike. Rreth e qark është i gdhendur mbishkrimi “PËR REZULTATE TË LARTA”, i cili është edhe titulli i medaljes si shenjë vlerësimi për merita dhe performancë të shkëlqyer.

Në qendër të medaljes ndodhet shqytja e Skënderbeut, me shqiponjën dykrenare të punuar në relief të artë të vendosur mbi sfond të kuq i realizuar me emaljo të kuqe të qelqtë, simbol i sovranitetit, guximit dhe identitetit kombëtar. Mbi mburojë qëndron e stilizuar në miniaturë perkrenarja e Skenderbeut, si një element dekorativ ceremonial, që përforcon karakterin zyrtar të medaljes dhe qëllimin e saj.

Në pjesën e poshtme të medaljes, janë vendosur degë dafine dhe lisi, të stilizuara me emaljo transparente në ngjyrë jeshile me detaje të arta, të cilat simbolizojnë nderin, forcën, qëndrueshmërinë dhe fitoren morale.

Medalja është e varur në një shirit moiré me gjerësi 37mm, me tre shirita vertikale blu të errët – të kuq – blu të errët, duke reflektuar solemnitët, autoritetin dhe dinjtëtin institucional.

➤ **Shiriti i medaljes (Spila ose barreta)**

Spila ose Barreta është me përmasa 35 x 10mm. E realizuar me shirit moiré me kombinim ngjyrash me tre shirita vertikale blu të errët – të kuq – blu të errët. Nga pas është e pajisur me kapse me dy gjilpëra për tu kapur në xhakëtë.



3. MEDALJE “PËR MERITA TË VEÇANTA”



Medalja është rrethore me diametër 35mm, e punuar në metal bronzi të praruar në Ar 999, me finicion mat dhe më shkëlqim e me detaje të relievuara. Në qendër ka një fushë të kuqe të emaluar me ngjyrën e flamurit kombtar. Në mes të saj qëndron e gdhendur në relief shqiponja dykrenore e flamurit e emaluar në ngjyrë të zezë të qelqtë, simbol i sovranitetit dhe identitetit kombtar.

Rreth e qark fushës qendrore është i gdhendur mbishkrimi “PËR MERITA TË VEÇANTA”, i cili është titulli i kësaj medalje. Në pjesën e poshtme të medaljes, janë vendosur degë lisi, të stilizuara me emaljo transparente në ngjyrë jeshile me detaje të arta, simbol i qëndrueshmërisë, trimërisë dhe meritës së fituar me përkushtim. Poshtë saj ndodhen katër yje pesëcepësh, të cilët përforcojnë idenë e vlerësimit të lartë dhe kontributit të jashtëzakonshëm.

Medalja është e varur në një shirit moiré me gjerësi 37 mm, e cila kombinon ngjyrën blu të errët në anët anësore me shirita vertikale të kuq dhe të zinj në qendër, duke reflektuar ngjyrat simbolike dhe dinjitetin e institucionit.

➤ **Shiriti i medaljes (Spila ose barreta)**

Spila ose Barreta është me përmasa 35 x 10mm. E realizuar me shirit moiré e cila kombinon ngjyrën blu të errët në anët anësore me shirita vertikale të kuq dhe të zinj në qendër. Nga pas është e pajisur me kapse me dy gjilpëra për tu kapur në xhakëtë.



4. MEDALJE “BRONZI”



Medalje Bronzi, e punuar në bronz.

Medalja është rrethore me diametër 35mm, e punuar në metal bronz me finicion mat dhe me shkëlqim e me detaje të relievuara. Në pjesën qendrore spikat një yll i madh pesëcepësh, i emaluar me ngjyrë të kuqe të qelqtë, i punuar në relief dhe i konturuar me detaje të holla që i japin thellësi dhe dinamizëm. Ylli simbolizon trimërinë, sakrificën dhe shkëlqimin.

Në pjesën e sipërme të medaljes është i gdhendur mbishkrimi “MEDALJA E KARRIERËS”, i cili është dhe titulli i saj. Përreth yllit qendror gjenden elementë dekorativë në formë vijash dhe yjesh më të vegjël, të cilët pasurojnë kompozimin dhe i japin medaljes një ndjesi lëvizjeje dhe harmonie dhe simboliken që përfaqëson.

Në pjesën e poshtme të medaljes, janë vendosur degë dafine dhe lisi, të stilizuara me emaljo transparente në ngjyrë jeshile me detaje të arta. Këto elemente simbolizojnë fitoren, nderin, forcën dhe qëndrueshmërinë morale.

Medalja është e varur në një shirit moiré me ngjyrë blu të errët si ngjyrë dominuese, e kombinuar me dy shirita vertikalë të kuq në anët, duke krijuar një kontrast elegant dhe solemn.

➤Shiriti i medaljes (Spila ose barreta)

Spila ose Barreta është me përmasa 35 x 10mm. E realizuar me shirit moire me ngjyrë blu të errët si ngjyrë dominuese, e kombinuar me dy shirita vertikalë të kuq në anët. Nga pas është e pajisur me kapse me dy gjilpëra për tu kapur në xhakëtë.



5. MEDALJE “ARGJENDI”



Medalje Argjendi, e punuar në bronz dhe argjenduar në Ag 999.

Medalja është rrethore me diametër 35mm, e punuar në metal bronzi me finicion mat dhe me shkëlqim e me detaje të relievuara. Në pjesën qendrore spikat një yll i madh pesëcepësh, i emaluar me ngjyrë të kuqe të qelqtë, i punuar në relief dhe i konturuar me detaje të holla që i japin thellësi dhe dinamizëm. Ylli simbolizon trimërinë, sakrificën dhe shkëlqimin.

Në pjesën e sipërme të medaljes është i gdhendur mbishkrimi “MEDALJA E KARRIERËS”, i cili është dhe titulli i saj. Përreth yllit qendror gjenden elementë dekorativë në formë vijash dhe yjesh më të vegjël, të cilët pasurojnë kompozimin dhe i japin medaljes një ndjesi lëvizjeje dhe harmonie dhe simbolikën që përfaqëson.

Në pjesën e poshtme të medaljes, janë vendosur degë dafine dhe lisi, të stilizuara me emaljo transparente në ngjyrë jeshile me detaje të arta. Këto elemente simbolizojnë fitoren, nderin, forcën dhe qëndrueshmërinë morale.

Medalja është e varur në një shirit moiré me ngjyrë blu të errët si ngjyrë dominuese, e kombinuar me dy shirita vertikalë të kuq në anët, duke krijuar një kontrast elegant dhe solemn.

➤ **Shiriti i medaljes (Spila ose barreta)**

Spila ose Barreta është me përmasa 35 x 10mm. E realizuar me shirit moire me ngjyrë blu të errët si ngjyrë dominuese, e kombinuar me dy shirita vertikalë të kuq në anët. Nga pas është e pajisur me kapse me dy gjilpëra për tu kapur në xhakëtë.



6.MEDALJE “ARI”



Medalje Ari, e punuar në bronz dhe pruar në Ar 999.

Medalja është rrethore me diametër 35mm, e punuar në metal bronzi me finicion mat dhe me shkëlqim e me detaje të rëluara. Në pjesën qendrore spikat një yll i madh pesëcepësh, i emaluar me ngjyrë të kuqe të qelqtë, i punuar në relief dhe i konturuar me detaje të holla që i japin thellësi dhe dinamizëm. Ylli simbolizon trimërinë, sakrificën dhe shkëlqimin.

Në pjesën e sipërme të medaljes është i gdhendur mbishkrimi “MEDALJA E KARRIERËS”, i cili është dhe titulli i saj. Përreth yllit qendror gjenden elementë dekorativë në formë vijash dhe yjesh më të vegjël, të cilët pasurojnë kompozimin dhe i japin medaljes një ndjesi lëvizjeje dhe harmonie dhe simboliken që përfaqëson.

Në pjesën e poshtme të medaljes, janë vendosur degë dafine dhe lisi, të stilizuara me emaljo transparente në ngjyrë jeshile me detaje të arta. Këto elemente simbolizojnë fitoren, nderin, forcën dhe qëndrueshmërinë morale.

Medalja është e varur në një shirit moiré me ngjyrë blu të errët si ngjyrë dominuese, e kombinuar me dy shirita vertikale të kuq në anët, duke krijuar një kontrast elegant dhe solemn.

➤ **Shiriti i medaljes (Spila ose barreta)**

Spila ose Barreta është me përmasa 35 x 10mm. E realizuar me shirit moire me ngjyrë blu të errët si ngjyrë dominuese, e kombinuar me dy shirita vertikale të kuq në anët. Nga pas është e pajisur me kapse me dy gjilpëra për tu kapur në xhakëtë.



➤ **Specifikimet teknike e Kutisë së Medaljeve**



Kutia është me përmasa 170 × 120 × 45 mm. Nga jashtë është e veshur me copë lëkure në ngjyrë të kuqe. Brenda është e veshur me stof të zi, ndërsa kapaku nga ana e brendshme ka veshje me stof ngjyre bezhë. Kutia është e njëjtë për të gjitha llojet e medaljeve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues “*Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Qendra e Furnizimit Materialo Teknik*” në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT